



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 3.7. 2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96, DATË 6.10.2016, “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 4.6.2018, dhe 3.7.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, propozim i deputetëve Ulsi Manja dhe Klotilda Ferhati.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar për projektligjin ishin të pranishëm z.Sokol Sadushi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, znj.Agnes Bernhard, drejtuese e Misionit Euralius në Shqipëri, z.John Smibert, Këshilltar Ligjor Rezident në OPDAT, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim deputeti, sipas përcaktimeve të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Projektligji ka si objekt ndryshimin e disa prej dispozitave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllimin për të rregulluar

zhvillimin normal të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës, si dhe në mënyrë që t'i hapet rruga emërimit të kandidatëve magjistratë të diplomuar në muajin qershor të vitit 2018, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Për shkak të moskonstituimit të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në veçanti të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës aktualisht ndodhet në pamundësinë e organizimit të provimit të pranimit për kandidatët për magjistratë, por edhe të mosemërimit të kandidatëve për magjistratë, që janë diplomuar në muajin qershor të vitit 2018.

Për shkak të kohës që do të nevojitej për ngritjen e Këshillave, dhe me qëllimin për të mos penguar zhvillimin normal të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës, Kuvendi e ka rregulluar me ligj, si organizimin e provimit, ashtu edhe numrin e kandidatëve fitues, të ndarë, sipas profilit gjyqtar e prokuror, për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018. Konkretisht, me ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (neni 68, pika 2), si dhe me ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (neni 285), është ngarkuar Shkolla e Magjistraturës që të organizojë konkursin "për pranimin e 25 kandidatëve për magjistratë, respektivisht për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018".

Tashmë këto dispozita kalimtare e kanë kryer efektin e tyre ligjor për dy vite akademike dhe nuk ndihmojnë në zgjidhjen e çështjes për vitin akademik 2018-2019.

Në rrethana të tilla:

- *megjenëse ende nuk janë krijuar Këshillat (KLGJ/KLP), të cilat ngarkohen nga ligji për të shpallur numrin maksimal të kandidatëve për magjistratë që do të pranohen në Formimin Fillestar për vitin e ri akademik;*
- *përderisa ligji parashikon disa afate, të cilat fillojnë në muajin janar dhe që detyrojnë organet përkatëse, Këshillat (KLGJ/KLP) dhe Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e provimit;*
- *duke qenë se ligji nuk lejon zhvillimin e provimit të pranimit, jo më vonë se muaji prill dhe shpalljen e listës së fituesve, jo më vonë se data 15 maj;*
- *duke marrë në konsideratë se ngritja e Këshillave nuk është bërë ende e mundur dhe nuk mund të parashikohet cili mund të jetë afati i krijimit të tyre;*

nga deputetët propozues, pas shqetësimit të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, u vlerësua si e vetmja zgjidhje marrja e iniciativës ligjore për të bërë një shtesë në ligjin nr. 96/2016, që të ngarkojë Shkollën e Magjistraturës të organizojë jo më vonë se muaji tetor, konkursin për pranimin kandidatëve për magjistratë për vitin akademik 2018-2019, dhe të dyfishit të këtij numri për vitin akademik 2019-2020. Ndarja e profilit si gjyqtar dhe prokuror për kandidatët fitues për çdo vit akademik përkatësisht 3/5 gjyqtarë dhe 2/5 prokurorë, përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, sipas renditjes përfundimtare.

Gjithashtu, në kushtet kur Këshillat nuk janë krijuar ende, dhe kandidatët që do të diplomohen në vitin 2018 nuk mund të emërohen dhe as të caktohen në pozicion, u vlerësua se e vetmja zgjidhje do të ishte marrja e iniciativës legislative për të bërë një ndryshim në një prej dispozitave ligjore të ligjit nr. 96/2016, në mënyrë që të lejojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm të emërojnë dhe caktojnë në pozicione kandidatët magistratë të diplomuar, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

III. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION DHE NDRYSHIMET E PROPOZUARA

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, anëtarët e Komisionit në diskutimet e tyre u fokusuan tek domosdoshmëria e ndryshimit të ligjit aktualisht në fuqi, me qëllimin për të rregulluar situatën e ardhur si pasojë e moskonstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Diskutime dhe opinione të ndryshme pati lidhur me propozimin që Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm të emërojnë dhe caktojnë në pozicione kandidatët magistratë e diplomuar në vitin 2018. Nga deputetët e grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integritet u kundërshtua vazhdimi i ushtrimit të kësaj kompetence nga KLD dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Përfaqësuesit e EURALIUS dhe OPDAT, duke vlerësuar rolin që ka Shkolla e Magjistraturës në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, mbështetën dhe u shprehën dakord me ndryshimet e propozuara.

Në përfundim të diskutimeve për projektligjin, gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi propozimin e relatorit për një riformulim të nenit 2 të projektligjit, me përmbajtje si vijon :

“Neni 2

Në nenin 170 shtohet pika 3 me përmbajtje si vijon:

"3. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe me qëllim plotësimin e nevojave për funksionimin e sistemit të drejtësisë, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të organizojë, jo më vonë se muaji tetor, konkursin për pranimin e 50 kandidatëve për magistratë për çdo vit akademik. Ndarja e profilit si gjyqtar dhe prokuror për kandidatët fitues për çdo vit akademik do të jetë përkatësisht 3/5 gjyqtarë dhe 2/5 prokurorë, që përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, sipas renditjes përfundimtare."."

Ky propozim për shtimin e numrit të kandidatëve, erdhi pas diskutimeve të zhvilluara në Komision lidhur me kapacitetet që mund të ofrojë Shkolla e Magjistraturës, si dhe situatës aktuale pas testimit të kryer nga kjo shkollë për këshilltarët ligjorë, pas të cilit ka rezultuar një numër i vogël kandidatësh fitues për të ndjekur magjistraturën.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, me ndryshimet e propozuara më sipër, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R

ADNOR SHAMETI

K R Y E T A R

ULSI MANJA